

VENDIM
Nr. 258, datë 2.12.2024

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 95, DATË 9.5.2022, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË PROKURORËVE”, NË LIDHJE ME METODOLOGJINË E PIKËZIMIT, ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT TË PROKURORIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME”

Mbështetur në nenet 149, pika 1, 149/a, pika 1, shkronja “a”, “ç” dhe “e” të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenet 25, 68–71, 73–78, 84–95, 97 dhe 171 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 159, pika 2, germa “a”, “ç” dhe “e”, 161, 164, pika 8, 184, shkronja “dh”, 189, pika 1, germa “c” dhe 190, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës i ngritur sipas urdhrit të kryetarit të KLP-së nr. 70, datë 15.4.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 95, datë 9.5.2022, “Për miratimin e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pas aneksit 11 të shtohet aneksi 12 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Kjo metodologji pikëzimi është pjesë përbërëse e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të miratuar me vendimin nr. 95, datë 9.5.2022, “Për miratimin e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot, më 2.12.2024.

KRYETAR
Mirela Bogdani

ANEKSI NR. 12
METODOLOGJIA E PIKËZIMIT ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT TË PROKURORIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

1. Metodologjia e pikëzimit ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit, për secilin kriter dhe treguesit përkatës ligjor, mbi bazën e një sistemi pikësh të përcaktuar mbi meritat e prokurorit, kualifikimin, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin e tij, duke respektuar parimin e pavarësisë së prokurorit.

2. Metodologjia e pikëzimit ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, në përshtatshmëri me detyrat e përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme. Në lidhje me këtë specifikë, metodologjia përcakton tregues dhe nëntregues për secilin nga kriteret e vlerësimit, duke marrë në konsideratë aktet nënligjore rregulluese të detyrave konkrete të prokurorëve, sipas natyrës së drejtorive, apo seksioneve në të cilin marrin pjesë.

3. Metodologjia e pikëzimit është pjesë përbërëse e “Skemës së vlerësimit”, sipas përcaktimeve të nenit 2, shkronja “ll”, të ligjit për statusin, i ndryshuar.

4. Me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit, pikëzimi bëhet duke u bazuar në kriteret e posaçme të parashikuara në nenet 68–71, 73–78, 84–95 dhe 97, të ligjit për statusin.

5. Për atë që ligji e lejon, përcaktimi i treguesve shtesë të çdo kriteri vlerësues dhe pesha specifike e tyre, bëhet në tabelën e pikëzimit, pjesë e kësaj metodologjie.

6. Vlerësimi i prokurorit kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

7. Vlerësimi i prokurorit kryhet sipas këtyre niveleve:

a) Vlerësimi i përgjithshëm “*Shkëlqyeshëm*” jepet në ato raste, kur prokurori është vlerësuar “*Shkëlqyeshëm*” për të katërta kriteret.

b) Vlerësimi i përgjithshëm “*Shumë mirë*” jepet vetëm në ato raste, kur prokurori vlerësohet “*Shumë mirë*” për tri kriteret dhe “*Mirë*” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “*aftësitë profesionale*” dhe “*etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale*” duhet të jenë vlerësuar “*Shumë mirë*”.

c) Vlerësimi i përgjithshëm “*Mirë*” jepet në rastin, kur aftësitë e prokurorit vlerësohen “*Mirë*” për dy kriteret dhe “*Mjaftueshëm*” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin, kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “*Mjaftueshëm*” dhe “*I pamjaftueshëm*”. Në çdo rast, kriteret “*aftësitë profesionale*” dhe “*etika dhe përkushtimi ndaj vlerave profesionale*” duhet të vlerësohen të paktën “*Mirë*”.

ç) Vlerësimi i përgjithshëm “*I pamjaftueshëm*” jepet në rastet, kur prokurori vlerësohet “*I pamjaftueshëm*” për të paktën në 3 kriteret ose kur prokurori vlerësohet “*I pamjaftueshëm*” për kriteret “*aftësitë profesionale*” dhe “*etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale*” dhe jo më shumë se “*Mirë*” për dy kriteret e tjera.

Për çdo kombinim tjetër të ndryshëm nga ato të parashikuar më lart, niveli i përgjithshëm i vlerësimit do të përcaktohet në varësi të mesatares së pikëve të katër kriterëve, sipas shkallës së pikëzimit të përcaktuar në pikën 9 të kësaj metodologjie. Në çdo rast, niveli i përgjithshëm i vlerësimit nuk mund të jetë më i lartë se niveli i vlerësimit për kriteret “*aftësitë profesionale*” dhe “*etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale*”.

8. Niveli i vlerësimit të prokurorit përcaktohet për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit.

9. Niveli i vlerësimit për çdonjërin nga kriteret e vlerësimit, përcaktohet mbi bazën e një shkalle pikëzimi nga 1 deri në 100 pikë.

10. Shkalla e pikëzimit që përcakton nivelet e vlerësimit është:

- a) 90 deri 100 pikë: “*Shkëlqyeshëm*”;
- b) 70 deri 89 pikë: “*Shumë mirë*”;
- c) 50 deri në 69 pikë: “*Mirë*”;
- ç) 30 deri në 49 pikë: “*Mjaftueshëm*”;
- d) 1 deri në 29 pikë: “*Pamjaftueshëm*”.

11. Brenda çdo kriteri vlerësimi bëhet ndarja e pikëve, sipas rëndësisë së çdo treguesi vlerësimi, duke shmangur përfundime që nuk janë përgjegjësi e prokurorit. Pikëzimi i çdo treguesi kryhet sipas rendit zbritës, duke filluar nga pikëzimi maksimal dhe caktohet në bazë të arsytimit mbi problematikën dhe gjetjet, të konstatuara në treguesit përkatës, që rezultojnë nga shqyrtimi i burimeve të vlerësimit.

12. Në tabelën e pikëzimit përcaktohet ndarja e kriterëve të vlerësimit, lista e aspekteve të çdo kriteri, treguesit e vlerësimit dhe pikëzimi i tyre sipas nivelit, në funksion të pikëzimit dhe të vlerësimit final të prokurorit.

13. Kjo metodologji është e përpiluar në dy pjesë, me qëllim përshtatjen e saj me detyrat konkrete të prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme. Duke marrë në konsideratë detyrat e tyre të përcaktuara në ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”, miratuar me urdhrin nr. 136, datë 28.10.2020, të prokurorit të përgjithshëm, ata ndahen në dy grupe: në të parin futen prokurori i Drejtorisë Gjyqësore dhe prokurori i strukturave të tjera në Prokurorinë e Përgjithshme, kur ushtron funksionet e përfaqësimit në Gjykatë të Lartë dhe Gjykatë Kushtetuese; në të dytin futen prokurori i Sektorit të Koordinimit dhe Studimeve, prokurori i Sektorit të Dekriminalizimit, prokurori i Sektorit të Monitorimit, prokurori i Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, prokurori i Sektorit të Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative. Për të njëjtën arsye, veprimtaria e tyre përcaktohet si *veprimtari me natyrë gjyqësore* (pjesa e parë) dhe *veprimtari me natyrë jogjyqësore* (pjesa e dytë).

14. Kur gjatë periudhës së vlerësimit, prokurori e ka ushtruar funksionin (pjesërisht) i caktuar pranë një drejtorie dhe (pjesërisht) pranë një drejtorie tjetër, të përfshira në grupe të ndryshme si më sipër, vlerësimi i tij etiko-profesional kryhet veçmas për secilën detyrë, sipas metodologjive përkatëse të vlerësimit të miratuara nga Këshilli.

15. Vlerësimi përfundimtar për periudhën e vlerësimit kryhet duke mbledhur pikët e secilit vlerësim etik dhe profesional. Çdo vlerësim etiko-profesional shumëzohet me thyesën me **numërues** (numrin e viteve që është ushtruar funksionin në një pozicion) dhe **emërues** (vitet e periudhës së vlerësimit)¹.

PJESA I (Veprimtari me natyrë gjyqësore)

1. AFTËSITË PROFESIONALE (100 pikë)

A. Njohuritë ligjore (50 pikë)

a) Aftësitë e përgjithshme juridike, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave (25 pikë).

b) Aftësia për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën (25 pikë).

B. Arsytimi ligjor (50 pikë)

a) Qartësia, saktësia dhe kuptueshmëria e akteve (20 pikë).

b) Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve (10 pikë).

c) Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik (20 pikë).

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE (100 pikë)

A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (100 pikë)

a) Aftësitë për të përballuar ngarkesën e punës. Numri i çështjeve të përfaqësuara në një vit, sipas ndarjes në: gjykime, masa sigurimi, hetime pasurore dhe gjykime të tjera. Numri i përgjithshëm i rekurseve të përfaqësuara në Gjykatën e Lartë, përfshirë rastet në Gjykatë Kushtetuese (60 pikë).

b) Aftësitë për të kryer procedurat gjyqësore (30 pikë).

c) Aftësitë për të administruar dosjen e përgatitur për gjykim, duke u bazuar në rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit (10 pikë).

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE (100 pikë)

A. Etika në punë (35 pikë)

a) Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

B. Integriteti (40 pikë)

a) Imuniteti ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, nderi dhe dinjiteti.

¹ Shembull. Në rast se gjatë periudhës 5-vjeçare të vlerësimit, prokurori e ka ushtruar njëkohësisht funksionin pranë Drejtorisë Gjyqësore, 2 vjet pranë Drejtorisë të Koordinimit dhe Studimeve, atëherë vlerësimi përfundimtar do të llogaritet: pikët sipas metodologjisë së vlerësimit të prokurorëve e Drejtorisë Gjyqësore (A) X (shumëzimi) 3/5 + pikët e vlerësimit sipas metodologjisë së vlerësimit të prokurorëve në Drejtorisë së Koordinimit Institucional (B) X 2/5. Në formë skematike formula do të ishte : $A \times 3/5 + B \times 2/5$.

C. Paanësia (25 pikë)

a) Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese (10 pikë).

b) Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve, për përjashtimin e prokurorit (15 pikë).

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)

A. Aftësia e komunikimit (40 pikë)

a) Komunikimi i qartë dhe transparent, në respektim të parimeve të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (40 pikë).

B. Aftësia për të bashkëpunuar (25 pikë)

a) Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta (15 pikë).

b) Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën (10 pikë).

C. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (35 pikë)

a) Pjesëmarrja e prokurorit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale (20 pikë).

b) Pjesëmarrja e prokurorit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun (5 pikë).

c) Publikimet ligjore akademike (10 pikë).

1.1 AFTËSITË PROFESIONALE TË PROKURORIT (100 pikë)

(Sipas nenit 73 të ligjit, por duke iu referuar edhe nenit 72 të tij.)

Për të pikëzuar aftësinë e prokurorit në drejtëm të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të aktit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së prokurorit, bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të akteve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi kontrolli nga ana e gjykatës.

Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit, pa gjykuar korrektësinë e aktit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

A. Njohuritë ligjore (50 pikë)

e) Aftësia e përgjithshme për të identifikuar konfliktin ligjor ndërmjet rekursit/kërkesës² të paraqitur dhe vendimit të gjykatës, në rastet në gjykim, si dhe aftësia për të paraqitur kundërshtimet në gjykim (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë aftësi të prokurorit, vlerësuesi përqendrohet në dokumentet ligjore të dorëzuara nga prokurori, në aktet e dosjeve të përzgjedhura me short (*konkluzionet e tij para gjykatës, vendimin e Gjykatës së Lartë ose Gjykatës Kushtetuese*), si dhe formularin e integruar të vlerësimit të prokurorit.

2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të ushtruar ndjekjen penale dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht aktivitetin juridik procedural sipas kërkesave ligjore, për të evidentuar dhe kërkuar provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësia për të përcaktuar dhe evidentuar faktet dhe rrethanat e çështjes objekt gjykimi, objektin e rekursit të prokurorit, si dhe rrethanat dhe faktet apo aktet e administruara, e që janë të nevojshme për t'u paraqitur para gjykatës, në mbështetje të konkluzioneve që ai mban për rastin në gjykim.

- Aftësia për të mbrojtur rekursin e prokurorit të apelit, për të paraqitur kundërshtimet në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës së apelit, bazuar në kërkesat e ligjit procedural për paraqitjen e rekursit

² Kërkesa referon te kërkesat përpara Gjykatës Kushtetuese dhe në gjykimin e të cilave merr pjesë përfaqësuesi i organit të prokurorisë.

në Gjykatën e Lartë, si dhe aftësia për të paraqitur kundërshtimet në lidhje me kërkesat përpara Gjykatës Kushtetuese.

- Aftësia për të identifikuar konfliktin ligjor, në veçanti referuar shkaqeve të rekursit me rëndësi për njësimin, ndryshimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore apo referuar shkaqeve të kërkesës në procesin kushtetues.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 1

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Numri i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

f) Aftësia për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe për të interpretuar ligjin, si dhe për të analizuar jurisprudencën në zgjidhjen e çështjes (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë aftësi, vlerësuesi përqendrohet në dokumentet ligjore të dorëzuara nga prokurori, aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, si dhe në formularin e integruar të vlerësimit të prokurorit

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësia për të përdorur doktrinën, parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale dhe interpretimin e ligjit, për të argumentuar konkluzionet që janë paraqitur në gjykatë, sipas natyrës së çështjes objekt gjykimi;

- Kërkimet për zbatimin e parashikimeve ligjore gjatë procedurës së gjyimit në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën Kushtetuese.

- Aftësia e prokurorit për të analizuar jurisprudencën, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën për rastin në gjykim. Në veçanti, vlerësohet nëse prokurori i referohet me saktësi dhe efikasitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit të qëllimit të gjyimit, praktikës së konsoliduar gjyqësore, praktikës së unifikuar/njësuar të Gjykatës së Lartë, praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ-së, edhe në rastet kur ajo nuk përbën burim të së drejtës, por i shërben argumentimit të qëndrimit që ai mban në diskutimin përfundimtar.

Vetëm referimi formal i ligjit ose i jurisprudencës, i pashoqëruar me një analizë të dispozitave, raportit midis tyre dhe zbatimit mbi rrethanat e faktit, sipas rastit, nuk mund të jetë tregues i aftësive për të interpretuar ligjin.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 2

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Numri i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

B. Arsytimi ligjor (50 pikë)

a) Qartësia, saktësia dhe kuptueshmëria e akteve (20 pikë)

Si burim vlerësimi për këtë tregues shërbejnë konkluzionet dhe aktet e tjera të dorëzuara nga prokurori, në dosjet e përzgjedhura me short, si dhe në formularin e integruar të vlerësimit të prokurorit.

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës;
- Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë;
- Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës;
- Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë, për të shprehur kuptimin.

Përdorimi në mënyrë korrekte dhe të qëndrueshme i termave teknikë.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 3

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Numri i pikëve
E dobët	4
Nën mesataren	8
Mesatare	12
Mbi mesataren	16
Shumë e lartë	20

b) Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve (10 pikë)

Si burim vlerësimi për këtë tregues shërbejnë konkluzionet dhe aktet e tjera të dorëzuara nga prokurori, në dosjet e përzgjedhura me short, si dhe formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit.

- Ndjekja e një metodologjie të caktuar sipas pjesëve përbërëse të dokumentit ligjor, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit (konkluzionet, rekursat etj.).

- Struktura e qartë, e qëndrueshme dhe e mirë-organizuar, e cila përmban:
- Prezantimin dhe analizën ligjore të fakteve;
- Identifikimin e dispozitave të zbatueshme të ligjit;
- Mënyrën se si lidhen këto elemente me njëri-tjetrin;
- Përfundimet.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 4

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Numri i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

c) Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik (20 pikë)

Si burim vlerësimi për këtë tregues shërbejnë konkluzionet dhe rekursat e dorëzuara nga prokurori, në dosjet e përzgjedhura me short, si dhe në formularin e integruar të vlerësimit të prokurorit, ku vlerësohet cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore.

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësia e prokurorit për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë ndërmjet faktit penal, provave të administruara në gjykim dhe dispozitave ligjore, dhe si janë parashtruar këto, në konkluzionet përfundimtare apo rekursat e paraqitura;
- Aftësia për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar;
- Nëse niveli i arsytimit plotëson standardin e procesit të rregullt ligjor;

- Nëse përmbajtja është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha fakteve të pretenduara (të argumentuara) apo të evidentuara gjatë gjykimit.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 5

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Numri i pikëve
E dobët	4
Nën mesataren	8
Mesatare	12
Mbi mesataren	16
Shumë e lartë	20

2.1 AFTËSITË ORGANIZATIVE TË PROKURORIT (100 pikë)

Megjithëse përgjegjësitë e prokurorit ndryshojnë midis juridiksioneve dhe roleve specifike, në mënyrë që të jetë produktiv, prokurori, në çdo nivel dhe në çdo detyrë, duhet të ketë aftësi të mira organizative. Prokurori, edhe ai në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk mund të jetë efektiv, pa pasur aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë prokurori përdor kohën e tij, qoftë në fazën përgatitore, qoftë dhe në atë të gjykimit.

Prokurori duhet të bëjë përpjekje maksimale në menaxhimin efektiv të kohës dhe në planifikimin e punës, pa krijuar pengesa në ecurinë e punës.

A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (60 pikë)

a) Aftësitë për të përballuar ngarkesën e punës. Numri i çështjeve të përfaqësuara në një vit, sipas ndarjes në: gjykime, masa sigurimi, hetime pasurore dhe gjykime të tjera. Numri i përgjithshëm i rekurseve të përfaqësuara në Gjykatën e Lartë apo kërkesave në Gjykatën Kushtetuese (60 pikë)

Si burim vlerësimi për këtë tregues shërbejnë të dhënat statistikore dhe formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit.

Për vlerësimin e këtij nënkriteri paraqet rëndësi, si numri i çështjeve të përfaqësuara në një periudhë të caktuar kohore, edhe pjesëmarrja në gjykim sipas natyrës së çështjeve, siç është parashikuar në: gjykime të shkurtuara, themeli, me riçelje të shqyrtimit gjyqësor, masa sigurimi, hetime pasurore dhe gjykime të tjera, apo dhe numri i përgjithshëm i rekurseve të përfaqësuara në Gjykatën e Lartë, apo kërkesave në Gjykatën Kushtetuese.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 6

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Numri i pikëve
E dobët	12
Nën mesatare	24
Mesatare	36
Mbi mesataren	48
Shumë e lartë	60

b) Aftësitë për të kryer procedurat gjyqësore (30 pikë)

Si burim vlerësimi shërbejnë të dhënat statistikore, procesverbali i seancës gjyqësore (transkript ose audio), si dhe formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit.

Për vlerësimin e këtij kriteri shqyrtohen rastet e shtyrjes së seancave gjyqësore, me kërkesë ose për shkak të prokurorit, si dhe kohëzgjatjes së gjykimit të kërkuar nga prokurori, për të paraqitur konkluzionet përfundimtare prej tij. Të gjitha të dhënat statistikore dhe procesverbalet gjyqësore analizohen për çështjet e shortuara për t'u vlerësuar sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e prokurorit. Analiza e të dhënave bazohet në kompleksitetin e çështjeve, në llojin, kohën dhe mënyrën e paraqitjes së kërkesave gjatë gjykimit, duke mbajtur parasysh, gjithashtu, edhe volumin e çështjeve, por dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, për periudhën që vlerësohet.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 7

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Numri i pikëve
E dobët	6
Nën mesataren	12
Mesatare	18
Mbi mesataren	24
Shumë e lartë	30

c) Aftësitë për të administruar dosjen e përgatitur për gjykim, duke u bazuar në rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit (10 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, si dhe në formularin e integruar të vlerësimit të prokurorit.

Treguesi i rregullshmërisë vlerësohet dhe pikëzohet në bazë të renditjes së akteve dhe rregullshmërisë së dokumentacionit (fizik apo elektronik) që prokurori u përcjell drejtuesve, ose Prokurorit të Përgjithshëm apo të tretëve (gjykatë/institucione të tjera), sipas rastit, në mënyrë të tillë që dokumentacioni të jetë lehtësisht i shfrytëzueshëm.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 8

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Numri i pikëve
Nën mesataren, për të gjitha vitet e vlerësimit	2
Nën mesataren, për shumicën e viteve të vlerësimit	4
Baras me mesataren, për shumicën e viteve të vlerësimit	6
Mbi mesataren, për shumicën e viteve të vlerësimit	8
Mbi mesataren, për të gjitha vitet e vlerësimit	10

3.1 ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE (100 pikë)

Pikëzimi i treguesve të këtij kriteri vlerësimi bëhet sipas një rendi zbritës, bazuar në parimin kushtetues që çdo prokuror, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Çdo prokuror e fillon procesin e vlerësimit me totalin e 100 pikëve, referuar këtij kriteri të vlerësimit. Gjatë procedurës së vlerësimit, pikët mund të zbriten në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues të dalë nga burimet e vlerësimit, krahasuar me ligjin, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes të miratuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë³.

³ Të cilat interpretohen, për aq sa është e mundur, në përputhje me:

i. Parimet e Bangalorit për sjelljen gjyqësore dhe komentari përkatës:

https://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf;

ii. Opinionin nr. 9 (2014), datë 17 dhjetor 2014, të CCPE (Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, për Këshillin e Evropës) “Mbi normat dhe parimet evropiane në lidhje me prokurorët”;

iii. Opinionin nr. 13 (2018) i CCPE-së “Për pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe etikën e prokurorëve”;

A. Etika në punë (35 pikë)

a) Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion (35 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit, rezultatet e ankesave dhe verifikimin e tyre, si dhe formularin e integruar të vlerësimit të prokurorit.

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësia e prokurorit për të pasur një sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi, gjatë ushtrimit të detyrës në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme;

- Aftësia për të shmangur çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe fyese, duke mos u kufizuar vetëm në shmangien e sjelljeve që formalisht kualifikohen si në kundërshtim me ligjin.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 9

Shkalla e etikës në punë e prokurorit	Numri i pikëve
E dobët	7
Nën mesataren	14
Mesatare	21
Mbi mesataren	28
Shumë e lartë	35

B. Integriteti (40 pikë)

a) Imuniteti nga çdo ndikim apo presion i jashtëm, nderi dhe dinjiteti (40 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit, në rezultatet e ankesave dhe verifikimin e tyre, në mendimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe në të dhënat e raporteve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Të dhënat e dala nga burimet e vlerësimit do të analizohen në mënyrë objektive, duke shmangur qëndrimin subjektiv të vlerësuesit apo anëtarit të Këshillit, të krijuar mbi bazën e njohjeve personale me prokurorin.

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Shmangia e lidhjeve të papërshtatshme me palët në proces ose shmangia e sjelljeve që bëjnë të duket sikur ka lidhje të tilla të papërshtatshme;

- Ushtrimi i detyrës me nder dhe dinjitet, në mënyrë që të përmbushë pritshmërinë e publikut;

- Shmangia e çdo paragjykimi, që mund të jetë i dëmshëm ose mund të konsiderohet si i dëmshëm për hetimin;

- Vetëdija e prokurorit, se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut;

- Përcjellja e vlerave personale dhe profesionale, duke shfaqur cilësitë personale, që i bëjnë të konsiderohen si shembuj të mirë për të tjerët;

iv. Udhëzimin e OKB-së, në vitin 1990, “Mbi rolin e prokurorëve”;

Standardet për përgjegjësinë profesionale dhe deklarata e detyrave dhe të drejtave themelore të prokurorëve, të përcaktuara në vitin 1999 nga IAP (Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve); udhëzimin e Budapestit, “Mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë”, 2005; deklaratën e Bordosë mbi “Gjyqtarët dhe prokurorët në shoqërinë demokratike”, në vitin 2009.

- Shmangia e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për dinjitetin e palëve;
- Keqpërdorimi i orarit të punës, personelit dhe burimeve të institucionit, për qëllime private;
- Çdo sjellje apo veprimtari tjetër, që cenon apo rrezikon të cenojë imazhin dhe figurën publike të prokurorit, prokurorisë dhe të sistemit të drejtësisë.

Parimet e Bangalorit konfirmojnë se nuk ka shkallë integriteti të përkufizuara si të tilla. Integriteti është një karakteristikë që prokurori e ka ose nuk e ka. Integriteti është absolut. Në sistemin e drejtësisë, integriteti është më shumë se një virtyt, është një domosdoshmëri. Prandaj, në përputhje me rrethanat, në caktimin e pikëve në dispozicion, sipas këtij treguesi, Këshilli mund të marrë në konsideratë dy mundësi, si më poshtë:

a) nëse ka informacione mjaftueshëm të besueshme se prokurorit i mungon integriteti, Këshilli do të caktojë minimumin e pikëve të mundshme;

b) nëse nuk ka informacione në dispozicion, që tregojnë se prokurorit i mungon integriteti, konkluzioni duhet të jetë në favor të prokurorit dhe Këshilli do të caktojë maksimumin e pikëve të mundshme.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 10

Shkalla e integritetit të prokurorit	Numri i pikëve
E dobët	0
Shumë e lartë	40

C. Paanësia (25 pikë)

Paanësia e prokurorit nënkupton mungesën e paragjykitimit në favor ose kundër palëve apo grupeve të veçanta. Këtu, Këshilli do të vlerësojë aftësinë e prokurorit për të shmangur një konflikt të mundshëm interesi, që ndikon ose mund të krijojë dyshime për paanësinë e tij, si dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave. Prokurori duhet të jetë i drejtë dhe të duket si i tillë. Paraqitja dhe cilësia e drejtësisë janë thelbësore.

a) Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese (10 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë kriter shërbejnë dokumentet ligjore të dorëzuara nga prokurori dhe aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave gjyqësore me mjete audio ose video, si dhe rezultatet e ankesave dhe verifikimit të tyre.

Prokurorët duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të shmangin përdorimin e gjuhës diskriminuese, si dhe çdo tendencë për paragjykim. Qëndrimet personale nuk duhet të ndërhyjnë në vendimmarrjen e prokurorit.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Respektimi i grupeve të cënueshme, i barazisë gjinore dhe i të drejtave të pakicave;
- Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese;
- Shmangia e çdo tendence për paragjykim;
- Shmangia e ndërhyrjes së mendimeve personale në vendimmarrjen e prokurorit.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 11

Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese	Numri i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8

Shumë e lartë	10
---------------	----

b) Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e prokurorit (15 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues shërbejnë të dhënat statistikore, si dhe formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit.

Pikëzimi i këtij treguesi bëhet sipas një rendi zbritës, bazuar në parimin kushtetues që çdo prokuror, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion. Në bazë të kësaj qasjeje, çdo prokuror e fillon procesin e vlerësimit me totalin e 15 pikëve, referuar këtij kriteri. Gjatë procedurës së vlerësimit, nëse konstatohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtim është “tejet i lartë”, prokurori do të vlerësohet me pikët minimale.

Për të vendosur, nëse numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e prokurorit është apo jo “tejet i lartë”, vlerësuesi, rast pas rasti, nuk përqendrohet vetëm në numrin e vendimeve të pranuar për përjashtimin e prokurorit, por analizon dhe krahason edhe tregues të tjerë të dalë nga burimet e vlerësimit, si për shembull: raportin ndërmjet kërkesave për heqje dorë të paraqitura nga prokurori, me kërkesat e pranuar të palëve për përjashtimin e tij. Prokurori nuk penalizohet nëse para vendimit të zëvendësimit, ai ka hequr dorë paraprakisht nga hetimi i çështjes, por kërkesa e tij nuk është pranuar nga drejtuesi i prokurorisë.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 12

Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e prokurorit	Numri i pikëve
Tejet i lartë	3
I pakonsiderueshëm	15

4.1 AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)

Ky kriter vlerëson kapacitetin personal dhe angazhimin profesional të prokurorit, siç detajohet në treguesit e mëposhtëm.

A. Aftësia e komunikimit (40 pikë)

a) Komunikimi i qartë dhe transparent me palët në proces, publikun, subjektet e tjera, të tretët (25 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues shërbejnë dokumentet ligjore të dorëzuara nga prokurori, aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, si dhe formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësia për të komunikuar në mënyrë efektive dhe transparente;
- Aftësia për t’u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe të saktë, me subjektet e procedimit penal, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 13

Qartësia dhe transparenca e komunikimit	Numri i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

b) Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (15 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues shërbejnë dokumentet ligjore të dorëzuara nga prokurori, aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, si dhe formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit.

Prokurori duhet të tregojë kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni, për shkak të funksionit. Pikëzimi i këtij treguesi bëhet sipas një rendi zbritës, duke prezumuar që prokurori i gëzon cilësi të tilla. Çdo prokuror e fillon pikëzimin me 15 pikë, të cilat zbriten sipas tabelës së mëposhtme, në varësi të treguesve që dalin nga burimet e vlerësimit.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Respektimi i dispozitave ligjore për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- Respektimi i udhëzimeve dhe i akteve nënligjore të nxjerra nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për aq sa gjejnë zbatim;
- Kushtimi i një vëmendjeje të veçantë ndaj të dhënave personale të rasteve delikate që përfshijnë të miturit, dhunën në familje etj.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 14

Respektimi i konfidencialitetit	Numri i pikëve
I dobët	3
Mesatar	9
I lartë	15

B. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët (25 pikë)**a) Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta (15 pikë)**

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues shërbejnë të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj prokurorit gjatë periudhës së vlerësimit, si dhe formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit.

Prokurori duhet të ketë aftësinë dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar me kolegët, pa cenuar pavarësinë e tij në vendimmarrje.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Angazhimi në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit të vendimeve njëse, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale, dhe në çdo çështje tjetër, që lidhet me veprimtarinë e prokurorisë;
- Gatishmëria për të ndarë me kolegët përvojën e përfutur në aktivitetet e ndryshme trajnuese.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 15

Shkalla e komunikimit	Numri i pikëve
E dobët	3
Nën mesataren	6
Mesatare	9
Mbi mesataren	12
Shumë e lartë	15

b) Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën (10 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues shërbejnë të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj prokurorit gjatë periudhës së vlerësimit, si dhe formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit.

Prokurorët e të gjitha niveleve ndërveprojnë rregullisht me personelin e prokurorisë. Nxitja e marrëdhënieve bashkëpunuese me personelin e prokurorisë krijon një ambient pune harmonik dhe produktiv. Këshilli do të vlerësojë, nëse nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi shfaqjen e mungesës së respektit ndaj punonjësve të administratës së prokurorisë, keqtrajtimin progresiv dhe sistematik të tyre, nëpërmjet përdorimit të fjalorit të papërshtatshëm, thashethemeve, përjashtimit social etj.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 16

Shkalla e komunikimit	Numri i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

C. Gatishmëria e prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (35 pikë)

a) Pjesëmarrja e prokurorit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale (20 pikë)

Një nga objektivat e vlerësimit të veprimtarisë profesionale është edhe identifikimi i nevojave për trajnim, duke i dhënë mundësi prokurorit t'i kushtojë kohë vetëpërmirësimit, në lidhje me njohjen dhe zbatimin e ligjit, jurisprudencës dhe doktrinë. Me qëllim ngritjen e tyre profesionale, prokurorët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Prokurori duhet t'i kushtojë kohë zhvillimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës matet duke u bazuar në informacionin me shkrim, që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e prokurorit në trajnime. Pjesëmarrja e prokurorit në trajnime të tjera vlerësohet, bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij, që tregojnë ngritjen profesionale.

Pikëzimi i këtij treguesi bëhet, referuar numrit të trajnimeve, kohëzgjatjes tërësore të tyre, në raport me një temë të caktuar. Këshilli konsideron vlerë të shtuar për ngritjen profesionale, trajnimet afatgjata, përfshirë edhe trajnimet afatshkurtra të specializuara në një fushë të caktuar, të organizuara në periudha kohore të ndërprera.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 17

Pjesëmarrja e prokurorit Periudha 3-vjeçare	Nr. i pikëve	Pjesëmarrja e prokurorit Periudha 5-vjeçare	Nr. i pikëve
15–120 ditë:	20	30–200 ditë:	20
Më pak se 15 ditë ose më shumë 120 ditë:	4	Më pak se 30 ditë ose më shumë 120 ditë:	4

b) Pjesëmarrja e prokurorit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun (5 pikë)

Si burime për pikëzimin shërbejnë formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit, të dhënat e dosjes personale të prokurorit, si dhe çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të prokurorit.

Prokurori mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin e drejtësisë, në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla, si: fjalime publike, prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit, bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues, angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit, kontribute në hartimin e legjislacionit, aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore, bashkëpunimi me grupe e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e cilësisë së sistemit të prokurorisë dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, nuk është gjithmonë në varësi të vullnetit të prokurorit, të gjithë prokurorët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues, me 3 pikë. Një ose dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim prokurorëve që kryejnë këto veprimtari, njëkohësisht me veprimtarinë hetimore, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes së prokurorit, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit, si dhe çdo të dhënë tjetër që del nga burimet e vlerësimit të këtij treguesi.

c) Publikimet ligjore akademike (10 pikë)

Si burim vlerësimi shërbejnë dosja personale e prokurorit dhe çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të tij, të cilat japin të dhëna për sasinë, tipologjinë dhe impaktin e punimeve dhe publikimeve ligjore akademike.

Me anë të këtij kriteri, Këshilli konsideron vlerë të shtuar për prokurorin, publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinë. Nga 5 deri në 10 pikë caktohen për publikimet ligjore akademike, ku përfshihen artikuj, kapituj, monografi ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

BURIMET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i prokurorëve bazohet në këto burime:

- a) dosja personale e prokurorit;
- b) të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90 të ligjit për statusin;
- c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91 të ligjit për statusin, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video;
- ç) formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit dhe aktet e përzgjedhura prej tij;
- d) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj prokurorit, gjatë periudhës së vlerësimit;
- dh) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e prokurorit në veprimtaritë trajnuese;
- e) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj prokurorit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është “shuar” ose “jo”;
- ë) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese;
- f) kundërshtimet e prokurorit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;
- g) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të prokurorit.

PJESA II (Veprimtari me natyrë jogjyqësore)

5. AFTËSITË PROFESIONALE (100 pikë)

A. Njohuritë ligjore (50 pikë)

a) Aftësitë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave (25 pikë).

b) Aftësia për të interpretuar ligjin (25 pikë).

B. Arsyetimi ligjor (50 pikë)

a) Qartësia, saktësia dhe kuptueshmëria e akteve (15 pikë).

b) Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve (10 pikë).

c) Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik (25 pikë).

6. AFTËSITË ORGANIZATIVE (100 pikë)

B. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (50 pikë)

a) Aftësia për të realizuar volumin normal të punës (25 pikë).

b) Aftësia për të respektuar afatet (25 pikë).

C. Efektiviteti dhe metodologjia (25 pikë)

a) Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës (25 pikë).

D. Rregullshmëria dhe saktësia (25 pikë)

a) Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit (10 pikë).

b) Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit (15 pikë).

7. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE (100 pikë)

A. Etika në punë (35 pikë)

a) Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

B. Integriteti (40 pikë)

a) Imuniteti ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, nderi dhe dinjiteti.

C. Paanësia (25 pikë)

a) Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

8. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)

D. Aftësia e komunikimit (40 pikë)

a) Komunikimi i qartë dhe transparent (25 pikë).

b) Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (15 pikë).

E. Aftësia për të bashkëpunuar (25 pikë)

a) Komunikimi dhe bashkëpunimi me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale (15 pikë).

b) Komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën (10 pikë).

F. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (35 pikë)

a) Pjesëmarrja apo mësimdhënia si ekspert, lehtësues apo moderator në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale (20 pikë).

b) Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë (10 pikë).

c) Publikimet ligjore akademike (5 pikë).

5.1 AFTËSITË PROFESIONALE TË PROKURORIT (100 pikë)

Për të pikëzuar aftësinë e prokurorit në drejtëm të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të dokumenteve të hartuara, vlerësuesi përqendrohet në formularin e integruar, dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura.

Vlerësuesi çmon aftësitë hulumtuese, interpretuese dhe logjikën e prokurorit, në lidhje me hartimin e dokumenteve ligjore, të tilla si: drafte aktesh nënligjore, projektvendime/vendime, opinione ligjore, analiza, materiale studimore krahasimore mbi kuadrin ligjor dhe jurisprudencial vendës dhe të huaj, projektraporte, raporte dhe materiale të tjera të lidhura me çështje specifike etj.

A. Njohuritë ligjore (50 pikë)

g) a) Aftësitë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësia hulumtuese, të cilat evidentojnë zotësinë e prokurorit për të shqyrtuar në mënyrë tërësore burimet e shtypura dhe *online* për të mbledhur informacione ligjore të sakta.
- Aftësia e prokurorit për të përcaktuar elementet faktuale të çështjes për trajtim dhe për të identifikuar natyrën e saj, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, sipas rastit.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

h) b) Aftësia për të interpretuar ligjin (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit në të cilat vlerësohet, sipas rastit (pozicionit të prokurorit dhe akteve përkatëse të përgatitura prej tij).

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësia për të interpretuar ligjin e identifikuar, arsyetimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet konkrete për trajtim, apo pasqyrimi dhe/ose analizimi i të dhënave në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Aftësia e prokurorit për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale, që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumenteve ligjore, dhe/ose në arsyetimet me shkrim ose verbale, sipas rastit;
- Për aq sa është e mundur, aftësia e prokurorit për të analizuar jurisprudencën, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar, në mbështetje të një interpretimi të caktuar.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

B. Arsyetimi ligjor (50 pikë)

i) a) Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria (15 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësuesi bazohet në dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Ky tregues pikëzohet referuar qartësisë, koncizitetit dhe lehtësisë në kuptueshmëri dhe lexueshmëri, të dokumenteve ligjore të hartuara/përpunuara nga prokurori.

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës;
- Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë;

- Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës;
- Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin;
- Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	3
Nën mesataren	6
Mesatare	9
Mbi mesataren	12
Shumë e lartë	15

j) b) Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumenteve ligjore (10 pikë)

Si burim vlerësimi për këtë tregues shërbejnë dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

- Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:
- Ndjekja e një metodologjie të caktuar sipas pjesëve përbërëse të dokumentit ligjor apo sipas udhëzimeve të dhëna, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit. Në matjen e këtij treguesi konsiderohet edhe shpeshtësia e kthimit të dokumenteve ligjore nga raportuesi, për shkak të gabimeve materiale, apo për mospërputhje me metodologjinë e unifikuar, apo strukturën e rakorduar, sipas rastit.
- Struktura e qartë, e qëndrueshme dhe e mirë-organizuar, e cila përmban:
- prezantimin e fakteve;
- identifikimin e dispozitave të zbatueshme të ligjit;
- dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, sipas rastit.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

k) c) Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përqendrohet dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Vlerësimi i do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësinë e prokurorit për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre ose se si ato zbatohen në lidhje me çështjen konkrete për trajtim;
- Cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore në dokumentet ligjore të hartuara/përpunuara nga prokurori. Në matjen e këtij treguesi konsiderohet edhe shpeshtësia e kthimit të dokumenteve ligjore nga raportuesi, për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentimit, nëse burimet e vlerësimit përmbajnë të dhëna të tilla.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË PROKURORIT (100 pikë)

Megjithëse përgjegjësitë e prokurorit mund të ndryshojnë, sipas roleve specifike dhe drejtorive ku ata janë caktuar, prokurori në çdo detyrë duhet të ketë aftësi të mira organizative, në mënyrë që të jetë produktiv. Prokurori nuk mund të jetë efektiv pa pasur aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat, pjesë e punës në Këshill. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë prokurori përdor kohën e tij/saj, si kur punon në autonomi, ashtu edhe në grup me të tjerë.

Prokurori duhet të bëjë përpjekje maksimale në menaxhimin efektiv të kohës, në lidhje me detyrat dhe skadencat e përcaktuara në ligj apo të vendosura si pjesë e punës në Prokurorinë e Përgjithshme, pa krijuar pengesa në ecurinë e punës në drejtorinë, seksionin apo në Prokurori të Përgjithshme.

A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (50 pikë)

a) Aftësia për të realizuar volumin normal të punës (25 pikë)

Si burim vlerësimi shërbejnë dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit, të dhënat statistikore.

Ky tregues konsideron profilin sasior të punës së prokurorit dhe vlerëson aftësinë tij për të realizuar volumin normal të punës që i caktohet, duke përfshirë edhe detyra të tjera si pjesë e aktiviteteve të përgjithshme, si p.sh.: pjesëmarrja në grupe pune, në procese raportimi, mbajtja dhe raportimi i të dhënave dhe çdo detyrë tjetër, sipas rastit.

Të dhënat në lidhje me këtë tregues duhet të analizohen sipas situatës, për të shmangur përfundime jo të favorshme, të lidhura me aspekte që nuk janë përgjegjësi e prokurorit. Përfundimet mbi të dhënat bazohen në kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e çështjeve, si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

b) Aftësia për të respektuar afatet (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues, si burim vlerësimi shërbejnë dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit, të dhënat statistikore.

Ky tregues konsideron profilin e shpejtësisë së punës së prokurorit dhe vlerëson respektimin nga ana e tij të afateve të parashikuara në aktet nënligjore të Prokurorisë së Përgjithshme apo të rakorduara me drejtorët e drejtorive, sipas rastit. Vlerësohet aftësia e prokurorit për të zgjidhur dhe përfunduar në afatin e duhur kohor çështjet dhe detyrat që i janë caktuar për trajtim.

Të dhënat në lidhje me këtë tregues duhet të analizohen sipas situatës, për të shmangur përfundime jo të favorshme për çështje që nuk janë përgjegjësi e prokurorit. Përfundimet mbi të dhënat bazohen në kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e çështjeve, si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

B. Efektiviteti dhe metodologjia (25 pikë)

1) a) Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës (25 pikë)

Vlerësuesi përqendrohet në dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit, të dhënat statistikore.

Aspekti i efektivitetit të punës së prokurorit nënkupton aftësinë e tij për të menaxhuar në mënyrë efektive kohën dhe burime të tjera në dispozicion, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, në raport me sasinë e punës.

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Realizimin efektiv dhe në kohë të veprimeve specifike procedurale dhe planit të punës;
- Aftësia për të evidentuar çështjet për përshpejtimin e punës ose ato me probleme procedurale;
- Aftësia e prokurorit për të qenë krijues dhe për të propozuar ide të reja për organizimin dhe menaxhimin efektiv të punës.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

C. Rregullshmëria dhe saktësia (25 pikë)

a) Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit (10 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit, të dhënat statistikore.

Treguesi i rregullshmërisë vlerësohet dhe pikëzohet në bazë të renditjes së akteve dhe rregullshmërisë së dokumentacionit (fizik apo elektronik) që prokurori i përcjell drejtuesve ose Prokurorit të Përgjithshëm apo aktet e praktikave përkatëse, sipas rastit, në mënyrë të tillë që dokumentacioni të jetë lehtësisht i shfrytëzueshëm.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

c) Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit (15 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit. Treguesi i saktësisë dhe plotësisë së

dokumentacionit vlerësohet dhe pikëzohet, duke mbajtur parasysh aftësinë e prokurorit për të garantuar që dokumentacioni (fizik apo elektronik) që gjyqtari u përcjell drejtorëve apo prokurorit të përgjithshëm, apo aktet e dosjeve përkatëse, sipas rastit, të jenë të plota, ato të duhurat dhe t'i përkasin çështjes konkrete në trajtim.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	3
Nën mesataren	6
Mesatare	9
Mbi mesataren	12
Shumë e lartë	15

9. 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE (100 pikë)

Pikëzimi i treguesve të këtij kriteri vlerësimi bëhet sipas një rendi zbritës, bazuar në parimin kushtetues që çdo prokuror, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Çdo prokuror e fillon procesin e vlerësimit me totalin e 100 pikëve, referuar këtij kriteri të vlerësimit. Gjatë procedurës së vlerësimit, pikët mund të zbriten në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues të dalë nga burimet e vlerësimit krahasuar me ligjin, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes të miratuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë⁴.

C. Etika në punë (35 pikë)

b) Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion (35 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues vlerësuesi përqendrohet në vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit, rezultatet e ankesave dhe verifikimin e tyre, si dhe formularin e integruar të vlerësimit të prokurorit.

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësia e prokurorit për të pasur një sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme;
- Aftësia për të shmangur çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe fyese, duke mos u kufizuar vetëm në shmangien e sjelljeve, që formalisht kualifikohen si në kundërshtim me ligjin.

Shkalla e etikës në punë e prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	7
Nën mesataren	14
Mesatare	21

⁴ Të cilat interpretohen, për aq sa është e mundur, në përputhje me:

vi. Parimet e Bangalorit për sjelljen gjyqësore dhe komentari përkatës,

https://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf;

vii. Opinionin nr. 9 (2014), datë 17 dhjetor 2014 të CCPE (Këshilli Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, për Këshillin e Evropës) “Mbi normat dhe parimet evropiane në lidhje me prokurorët”;

viii. Opinionin nr. 13 (2018) i CCPE-së “Për pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe etikën e prokurorëve”;

ix. Udhëzimin e OKB-së i vitit 1990, “Mbi rolin e prokurorëve”;

x. Standardet për përgjegjësinë profesionale dhe deklarata e detyrave dhe të drejtave themelore të prokurorëve, të përcaktuara në vitin 1999 nga IAP (Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve); udhëzimin e Budapestit “Mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë”, 2005; DEKLARATA e Bordosë mbi “Gjyqtarët dhe prokurorët në shoqërinë demokratike”, e vitit 2009.

Mbi mesataren	28
Shumë e lartë	35

D. Integriteti (40 pikë)

b) Imuniteti nga çdo ndikim apo presion i jashtëm, nderi dhe dinjiteti (40 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit, në rezultatet e ankesave dhe verifikimin e tyre, dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit, dhe në të dhënat e raporteve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. **Të dhënat e dala nga burimet e vlerësimit do të analizohen në mënyrë objektive, duke shmangur qëndrimin subjektiv të vlerësuesit apo anëtarit të Këshillit, të krijuar mbi bazën e njohjeve personale me prokurorin.**

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtëm:

- Shmangia e lidhjeve të papërshtatshme ose shmangien e sjelljeve, që bëjnë të duket sikur ka lidhje të tilla të papërshtatshme;
- Ushtrimi i detyrës me nder dhe dinjitet, në mënyrë që të përmbushë pritshmërinë e publikut;
- Shmangia e çdo paragjykimi që mund të jetë i dëmshëm ose mund të konsiderohet si i dëmshëm për kryerjen e detyrave të caktuara;
- Vetëdija e prokurorit se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut;
- Përcjellja e vlerave personale dhe profesionale, duke shfaqur cilësitë personale, që i bëjnë të konsiderohen si shembuj të mirë për të tjerët;
- Shmangia e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për dinjitetin e individëve;
- Keqpërdorimi i orarit të punës, personelit dhe burimeve të institucionit, për qëllime private;
- Çdo sjellje apo veprimtari tjetër, që cenon apo rrezikon të cenojë imazhin dhe figurën publike të prokurorit, të Këshillit dhe të sistemit të drejtësisë.

Parimet e Bangalorit konfirmojnë se nuk ka shkallë integriteti të përkufizuara si të tilla. Integriteti është një karakteristikë që prokurori e ka ose nuk e ka. Integriteti është absolut. Në sistemin e drejtësisë, integriteti është më shumë se një virtyt, është një domosdoshmëri. Prandaj, në përputhje me rrethanat, në caktimin e pikëve në dispozicion, sipas këtij treguesi, Këshilli mund të marrë në konsideratë dy mundësi, si më poshtë:

a) nëse ka informacione mjaftueshëm të besueshme se prokurorit i mungon integriteti, Këshilli do të caktojë minimumin e pikëve të mundshme;

b) nëse nuk ka informacione në dispozicion që tregojnë se prokurorit i mungon integriteti, konkluzioni duhet të jetë në favor të prokurorit dhe Këshilli do të caktojë maksimumin e pikëve të mundshme.

Shkalla e integritetit të prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	0
Shumë e lartë	40

C. Paanësia (25 pikë)

Në lidhje me këtë parim, paanësia e prokurorit në nënkupton mungesë paragjykimi në favor, ose kundër prokurorëve, grupeve të veçanta, apo çështjeve për trajtim. Këshilli do të vlerësojë këtu imunitetin ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, aftësinë e prokurorit për të shmangur një konflikt të mundshëm interesi, që ndikon ose mund të krijojë dyshime për paanësinë e tij, si dhe respektimin

e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave. Prokurori duhet të jetë i drejtë dhe të duket si i tillë. Paraqitja dhe cilësia e drejtësisë janë thelbësore.

c) Përdorimi ose “jo” i gjuhës diskriminuese (25 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë kriter, shërbejnë masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit (nëse ka), rezultatet e ankesave dhe verifikimi i tyre, dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Prokurorët duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të shmangin përdorimin e gjuhës diskriminuese, si dhe çdo tendencë për paragjykim. Qëndrimet personale nuk duhet të ndërhyjnë në vendimmarrjen e prokurorit.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Respektimi i grupeve të cënueshme, të barazisë gjinore dhe i të drejtave të pakicave;
- Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese;
- Shmangia e çdo tendence për paragjykim;
- Shmangia e ndërhyrjes së mendimeve personale në vendimmarrjen e prokurorit.

Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

10. 4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)

Ky kriter vlerëson kapacitetin personal dhe angazhimin profesional të prokurorit, që detajohet në treguesit e mëposhtëm.

6.1 A. Aftësia e komunikimit (40 pikë)

m)

c) Komunikimi i qartë dhe transparent (25 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit, të dhënat statistikore.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësia për të komunikuar në mënyrë efektive dhe transparente;
- Aftësia për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe të saktë me kolegët, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.

Qartësia dhe transparenca e komunikimit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

d) Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (15 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit, të dhënat statistikore.

Prokurori duhet të tregojë kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni, për shkak të funksionit. Pikëzimi i këtij treguesi bëhet sipas një rendi zbritës, duke prezumuar që prokurori i

gëzon cilësi të tilla. Çdo prokuror e fillon pikëzimin me 15 pikë, të cilat zbriten sipas tabelës së mëposhtme, në varësi të treguesve që dalin nga burimet e vlerësimit.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Respektimi i dispozitave ligjore për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- Respektimi i udhëzimeve dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për aq sa gjejnë zbatim;

Respektimi i konfidencialitetit	Nr. i pikëve
I dobët	3
Mesatar	9
I lartë	15

C. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët (25 pikë)

c) Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale (15 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Prokurori duhet të ketë aftësinë dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar me kolegët pa cenuar pavarësinë e tij në vendimarrje.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Angazhimi në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit të vendimeve njehsuese, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale dhe në çdo çështje tjetër, që lidhet me veprimtarinë e Prokurorisë së Përgjithshme;
- Gatishmëria për të ndarë me kolegët përvojën e përftuar në aktivitetet e ndryshme trajnuese.

Shkalla e komunikimit	Nr. i pikëve
E dobët	3
Nën mesataren	6
Mesatare	9
Mbi mesataren	12
Shumë e lartë	15

d) Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën (10 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Prokurorët ndërveprojnë rregullisht me personelin e Prokurorisë së Përgjithshme. Nxitja e marrëdhënieve bashkëpunuese me personelin krijon një ambient pune harmonik dhe produktiv. Këshilli do të vlerësojë, nëse nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi shfaqjen e mungesës së respektit ndaj punonjësve të administratës së prokurorisë, keqtrajtimin progresiv dhe sistematik të tyre, nëpërmjet përdorimit të fjalorit të papërshtatshëm, thashethemeve, përjashtimit social etj.

Shkalla e komunikimit	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

C. Gatishmëria e prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (35 pikë)

b) Pjesëmarrja e prokurorit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale (20 pikë)

Një nga objektivat e vlerësimit të veprimtarisë profesionale është edhe identifikimi i nevojave për trajnim, duke i dhënë mundësi prokurorit t'i kushtojë kohë vetpërmirësimit, në lidhje me njohjen dhe zbatimin e ligjit, jurisprudencës dhe doktrinë. Me qëllim ngritjen e tyre profesionale, prokurorët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Prokurori duhet t'i kushtojë kohë zhvillimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnime që nxitin specializimin e tij, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnime në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim, që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e prokurorit në trajnime. Pjesëmarrja e prokurorit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij, që tregojnë ngritjen profesionale.

Pikëzimi i këtij treguesi bëhet referuar numrit të trajnimeve, kohëzgjatjes tërësore të tyre në raport me një temë të caktuar. Këshilli konsideron vlerë të shtuar për ngritjen profesionale trajnimet afatgjata, përfshirë edhe trajnimet afatshkurtra të specializuara në një fushë të caktuar, të organizuara në periudha kohore të ndërprera.

Pjesëmarrja e prokurorit Periudha 3-vjeçare	Nr. i pikëve
15–120 ditë:	20
Më pak se 15 ditë ose më shumë 120 ditë:	4

Pjesëmarrja e prokurorit Periudha 5-vjeçare	Nr. i pikëve
30–200 ditë:	20
Më pak se 30 ditë ose më shumë 120 ditë:	4

b) Pjesëmarrja e prokurorit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun (5 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit, si dhe çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të prokurorit.

Prokurori mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin e drejtësisë në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike, prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit, bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues, angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit, kontribute në hartimin e legjislacionit, aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore, bashkëpunimi me grupe e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e cilësisë së sistemit të prokurorisë dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla nuk është gjithmonë në varësi të vullnetit të prokurorit, të gjithë prokurorët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë. Një ose dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim prokurorëve që kryejnë këto veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë hetimore, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes së prokurorit, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit, si dhe çdo e dhënë tjetër që del nga burimet e vlerësimit të këtij treguesi.

ç) Publikimet ligjore akademike (5 pikë)

Si burim vlerësimi shërbejnë dosja personale e prokurorit dosjet e shortuara, aktet e përzgjedhura, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit, të dhënat statistikore dhe çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të tij, të cilat japin të dhëna për sasinë, tipologjinë dhe impaktin e punimeve dhe publikimeve ligjore akademike.

Me anë të këtij kriteri, Këshilli konsideron vlerë të shtuar për prokurorin publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinë. Nga 1 deri në 5 pikë caktohen për publikimet ligjore akademike, ku përfshihen artikuj, kapituj, monografi ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

BURIMET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i prokurorëve bazohet në këto burime:

- a) dosja personale e prokurorit;
- b) të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90 të ligjit për statusin;
- c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91 të ligjit për statusin, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video;
- ç) formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit dhe aktet e përzgjedhura prej tij;
- d) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj prokurorit gjatë periudhës së vlerësimit;
- dh) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e prokurorit në veprimtaritë trajnuese;
- e) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj prokurorit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është “shuar” ose “jo”;
- ë) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese;
- f) kundërshtimet e prokurorit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;
- g) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të prokurorit.